

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 25.07.2024*

**25.07.2024  
Ora 11:33**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E.Meta.
- **Parti Politike:** S’ka prezent!
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme publike në rend dite kemi pesë çështje:


- Shqyrtimin e kërkesës të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

- Kemi tre plotësime vakancash për këshillin e: Bashkisë Gramsh, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Kavajë. Si dhe,

- Projektvendimin që lidhet me caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private për zgjedhjet e Himarës.

Po, për pikën e parë, Pavlina! Shkurt për regjistrimin, për kërkesën për t’u regjistruar si koalicion.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 25.07.2024*

**Znj. P. Doçaj:** Po, “Partia Demokratike” e përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, brenda afatit ligjor të përcaktuar me vendimin nr. 3, datë 17.07.2024 të Kolegjit Zgjedhor, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen me datën 4 gusht 2024. Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit është depozituar dhe marrëveshja e nënshkruar nga kryetarët e partive politike, pjesëmarrëse në koalicion, të cilat do të jenë:

- “Partia Demokratike”;
- “Partia e Lirisë”;
- “Partia Demokristiane e Shqipërisë”;
- “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”;
- “Partia Fryma e Re Demokratike”;
- “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”;
- “Partia Balli Kombëtar Demokrat”;
- “Partia Balli Kombëtar”;
- “Partia Republikane Shqiptare”;
- “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”.

Marrëveshja e depozituar përmban të gjitha specifikimet e parashikuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, në të cilën, përkatësisht në pikën 1 të këtij neni përcaktohet rrethi i subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor. Në interpretim të sa më sipër, pra të kësaj dispozite, kërkesa e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” plotëson të gjitha kriteret për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimin për miratimin tuaj.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 25.07.2024*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord, atëherë meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhorë, në lidhje me kërkesën për t'u regjistruar si koalicion është në përputhje me parashikimet e ligjit: e miratojmë këtë kërkesë, duke regjistruar Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, me shkronja nistore BF si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024. Me parti pjesëmarrëse: “Partia Demokratike”, “Partia e Lirisë”, “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, “Partia Balli Demokrat”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia Republikane Shqiptare” dhe “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”.

**Vendimi nr. 124**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.11.07.2024*

25.07.2024

Ora 11:36

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë,  
Gramsh dhe Kavajë”.**

**PJESËMARRJA :**


**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Po, këto plotësimet e vakancave, në një relativitet të treja.

**Znj. P. Doçaj:** Po, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Gramsh, Këshilli i Bashkisë Kavajë, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këshillat bashkiakë përkatës. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kemi vijuar me verifikimin e kandidatëve vijues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore përkatëse. Më pas i jemi drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore për të kërkuar informacion dhe në përgjigje të informacionit të kërkuar, rezulton se kandidatët nuk kanë dënime penale të formës së prerë dhe nuk kanë ndryshime në gjeneralitete. Në këto kushte, mbështetur dhe në pikën 2 të kreut 5, të vendimit 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiakë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë në këto funksione. Bashkëlidhur dhe projektvendimi për miratimin tuaj.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.11.07.2024*


**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë, dakord edhe me të tre projektvendimet për sa i përket plotësimit të vakancave në Bashkinë e Lezhës, të Gramshit dhe të Kavajës.

---

**Vendimi nr. 125, 126, 127.**

---

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për zgjedhjet e pjesshme të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E.Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Pika e fundit e rendit të ditës!

**Z. E. Meta:** Referuar nenit 93 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 1 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk kanë mundësi për ndërtesa publike. Kryetari në detyrë i Bashkisë Himarë, në datën 16.07.2024 ka propozuar shtatë qendra votimi në ndërtesa private. Nga shtatë propozimet e bashkisë, pesë propozime janë vlerësuar se janë në përputhje me kërkesat dhe nenin 93 të Kodit Zgjedhor si dhe të udhëzimit 1 të Komisionit Rregullator. Të gjitha këto qendra votimi kanë shërbyer në procesin zgjedhor të datës 14 maj 2023. Ndërsa për dy qendrat e votimit të propozuara, nuk janë paraqitur dy alternativa dhe nga verifikimi në terren rezulton se ka alternativa të tjera të mundshme. Për vendndodhjen e pesë qendrave të votimit të propozuara për miratim, inspektimi në terren ka konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Për dy

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 25.07.2024*

qendrat e tjera, që nuk janë përfshirë në këtë projektvendim, inspektimi ka evidentuar probleme me fshehtësinë e votës dhe është kërkuar që Bashkia Himarë të paraqesë propozime alternative. Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për zgjedhjet e pjesshme të datës 4 gusht 2024” për pesë qendrat e votimit, konkretisht qendrat e votimit: 4579, 4584, 4584/1, 4582 dhe 4561.

**Z.I. Celibashi:** Mirë, atëherë, miratojmë kërkesën për vendosje në ambiente private të qendrave të votimit: 4579, 4584, 4584/01, 4582 dhe 4561, për dy qendrat e tjera do të jemi në proces vlerësimi akoma. Çëshje të tjera? Nuk kemi. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 128**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

